


Aksidentet Rrugore

Janar 2019

Tiranë, më 21 Shkurt 2019 Në muajin Janar 2019 numërohen 104 aksidente rrugore nga 134 aksidente të ndodhur në Janar 2018, duke ulur me 22,4 % krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Fig. 1 Aksidentet rrugore mujore, Janar 2015 – Janar 2019



Në Janar 2019, numri i të aksidentuarve (të vrarë dhe të plagosur) është 153 persona nga 175 që ishte një vit më parë, duke ulur 12,6 %.

Në muajin Janar 2019, numri i të vdekurve nga aksidentet rrugore është 15 persona nga 13 që ishte një vit më parë.

Në Janar 2019, aksidentet rrugore, në 86,5 % të rasteve, kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesit të mjetit. Numri më i lartë i aksidenteve në këtë periudhë është kryer nga grup moshë 25 –35 vjeç duke zënë 28,8 % të numrit të aksidenteve gjithsej. Aksidentet në këtë grup moshë janë rritur me 30,4 % krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab. 1 Aksidentet rrugore

Periudha	Aksidente	Të vdekur		Të plagosur	
	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj
Janar -2018	134	1	12	51	111
Janar -2019	104	5	10	49	89
Ndryshimi vjetor (%)	-22,4	400,0	-16,7	-3,9	-19,8

Tab. 2 Aksidentet rrugore, sipas përdoruesve të rrugës

Periudha	Aksidentet sipas		Të vdekur	
	Sjellja e drejtuesit të mjetit	Sjellja e këmbësorit	Sjellja e drejtuesit të mjetit	Sjellja e këmbësorit
Janar 2018	100	34	9	4
Janar 2019	90	14	14	1
Ndryshimi vjetor (%)	-10,0	-58,8	55,6	-75,0

Tab. 3 Aksidentet rrugore, sipas moshës së drejtuesit të mjetit

Periudha	0- 25 vjeç	25- 35 vjeç	35- 45 vjeç	45-60 vjeç	60+ vjeç	Larguar nga vendi i ngjarjes
Janar -2018	26	23	28	33	10	14
Janar- 2019	23	30	23	18	4	6
Ndryshimi vjetor (%)	-11,5	30,4	-17,9	-45,5	-60,0	-57,1

Tab. 4 Aksidentet rrugore sipas qarqeve

Periudha	Aksidente		Të vdekur	
	Janar 2018	Janar 2019	Janar 2018	Janar 2019
Shqipëria	134	104	13	15
Tiranë	61	46	3	2
Durrës	17	7	2	2
Shkodër	2	1	1	1
Elbasan	9	6	3	2
Fier	5	12	1	5
Vlorë	8	2	0	1
Korce	3	4	0	0
Lezhë	13	19	2	1
Berat	6	2	0	1
Kukës	2	2	1	0
Diber	4	0	0	0
Gjirokastrë	4	3	0	0

Përkufizime

Aksidente: Aksidentet rrugore që ndodhin tek një ose më shumë persona që goditen nga mjetet e qarkullimit rrugor.

I vdekur: I vdekur nga aksidenti në rrugë quhet çdo person i cili ka vdekur menjëherë ose brenda 30 ditëve si rezultat i aksidentit.

I plagosur: I plagosur konsiderohet çdo person, i cili nuk ka vdekur por ka marrë plagë të lehta apo të rënda si rezultat i aksidentit.

Sjellja e Drejtuesit të Mjetit : Nënkupton nëse drejtuesi i mjetit nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas “Kodit Rrugor” si: frenim i papritur, injoron shenjat (sinjalistikën) e trafikut, mosrespektimi i normave të shpejtësisë etj.

Sjellja e Këmbësorëve: Nënkupton nëse këmbësori nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas “Kodit Rrugor” si : kalim rruge pa kujdes, etj.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme/Drejtoria e Policisë së Shtetit.

Të dhënat e muajit të fundit mbi Personat e vdekur nga aksidentet rrugore janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.